



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2022:208409

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05332914

C.nr. 387/22

Gjykata Themelore Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, me bashkëpunëtore Albulena Morina-Lulaj, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit: M. K. , nga fshati P... , Komuna Klinë, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve ‘... &...’ L.L.C, me seli në P... , kundër të paditurës: K... e S... ‘D... ’, me seli në Prishtinë, Rr.’...’, p.n., me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 5000€, jashtë seancës gjyqësore me datë 14.02.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I.KONSTATOHET e tërhequr padia e datës 07.10.2022, e paditësit M. K. , kundër të paditurës: K... S... ‘D...’, me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 5000€.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në këtë gjykatë, paditësi përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar padi me datë 07.10.2022, kundër të paditurës: K... e S... ‘D...’, me seli në P... , me bazë juridike: kompensim dëmi, vlera e kontestit: 5000€.

Përfaqësuesi i paditësit pas seancës përgatitore të mbajtur me datë 09.10.2023, me parashtresën e datës 25.01.2024, e ka njoftuar gjykatën që e tërheq padinë në raport me të paditurën, pasi që kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Sipas nenit 261 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. . Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c dhe nenit 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.387/22, datë 14.02.2024.

Gj y q t a r j a:
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.